

VENDIM
Nr. 366, datë 20.5.2026

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, ME VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 3268, FSHATI SAVËR, NJËSIA ADMINISTRATIVE LUSHNJË,
BASHKIA LUSHNJË, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA “3X ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në zonën kadastrale 3268, fshati Savër, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, qarku Fier, nga shoqëria “3X Energy” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “3X Energy” sh.p.k.;
- b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: M53804401H;
- c) Tipi i centralit: Fotovoltai;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 70 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaike do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën kadastrale 3268, fshati Savër, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, qarku Fier;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) Shoqëria “3X Energy” sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht, çdo tre muaj, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “3X Energy” sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) %, të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;


v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “3X Energy” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

ANEKSI 1



OBJEKTI: 3X ENERGY SOL PARK, 70 MW

Titulli: Koordinatat e Parkut Fotovoltaik (Sistemi koordinativ KRRGJSH dhe GAUS KRUGER)

KORDINATAT NË KRGJSH 3X ENERGY SOL PARK, 70 mw DHE VEPRAT NDIHMËSE

Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N	
1	472363.5	4529118		9	472270.3	4529079		17	472256	4529476	
2	472618.8	4529216		10	472013.5	4529231		18	472289.1	4529509	
3	472500.5	4529031		11	471880.9	4529362		19	472155.5	4529638	
4	471919.4	4528521		12	472001.6	4529484		20	472392.2	4529876	
5	471717.6	4528642		13	472135.6	4529354		21	472522.9	4529745	
6	471926.1	4528972		14	472201.4	4529421		22	471594.3	4529653	
7	472016.4	4528990		15	472067.6	4529550		23	471464.3	4529783	

8	472255.4	4529087		16	472122.4	4529605		24	471611.8	4529931	
---	----------	---------	--	----	----------	---------	--	----	----------	---------	--

Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N	
25	471741.7	4529801		33	472370.4	4530342		41	472564.6	4530472	
26	471780.8	4529840		34	472421.9	4530376		42	472630.8	4530516	
27	471650.9	4529970		35	472292.2	4530511		43	472501.7	4530650	
28	471976.1	4530293		36	472370	4530563		44	472557.1	4530687	
29	472104.8	4530165		37	472499.5	4530428		45	472691.7	4530557	
30	472138.2	4530186		38	472537	4530453		46	472705.7	4530542	
31	472004.3	4530319		39	472407.7	4530588		47	472832	4530422	
32	472240.6	4530477		40	472435.3	4530606		48	472273.6	4530050	
								49	472149.1	4530175	

KORDINATAT NË ALBANIAN 1986/GK4 3X ENERGY SOL PARK,70 mw DHE VEPRAT NDIHMËSE

Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N	
1	4388226	4530046		9	4388132	4530009		17	4388122	4530405	
2	4388482	4530142		10	4387877	4530163		18	4388156	4530438	
3	4388362	4529957		11	4387746	4530295		19	4388024	4530569	
4	4387775	4529454		12	4387868	4530416		20	4388263	4530804	
5	4387574	4529578		13	4388001	4530285		21	4388392	4530671	
6	4387787	4529905		14	4388067	4530351		22	4387463	4530590	
7	4387877	4529922		15	4387935	4530481		23	4387334	4530722	
8	4388117	4530016		16	4387990	4530536		24	4387483	4530868	

Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N	
25	4387612	4530736		33	4388247	4531270		41	4388442	4531398	
26	4387651	4530775		34	4388299	4531304		42	4388508	4531440	
27	4387523	4530906		35	4388171	4531440		43	4388382	4531577	
28	4387852	4531225		36	4388249	4531491		44	4388437	4531613	
29	4387979	4531096		37	4388377	4531355		45	4388571	4531481	
30	4388013	4531117		38	4388415	4531380		46	4388584	4531466	
31	4387880	4531252		39	4388287	4531515		47	4388709	4531345	
32	4388118	4531406		40	4388315	4531533		48	4388147	4530980	
								49	4388024	4531106	